

SNA-të Përkatëse

Çështje të Veçanta për të Marrë në Konsideratë

Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme (SNA 560)

- Marrja në konsideratë që shtyrja e afatit të caktuar të raportimit rrit periudhën (dhe si rrjedhojë rreziqet e lidhura) për ngjarjet që ndodhin ndërmjet datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit.
- Identifikimi i çfarëdo ngjarje të mëvonshme materiale në lidhje me COVID-19, dhe nëse ato janë adresuar në mënyrë të duhur ose shpjeguar në shënimet në pasqyrat financiare në përputhje me kuadrin e raportimit financiar.

Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me vijmësinë (i rishikuar) SNA 570


- Impakti i COVID-19 (d.m.th., nëse ka ndikuar apo pritet që të ndikojë në mënyrë materiale) në vlerësimin e audituesit për vlerësimin e drejtimit mbi vijmësinë.
- Rishqyrimi i përshtatshmërisë së përdorimit të bazës së vijmësisë për përgatitjen e pasqyrave financiare, ose modifikimin e raportit të audituesit sipas nevojës.

Auditimet e grupit (SNA 600)

- Nëse është e aplikueshme, rivlerësimi i procedurave të planifikuara të audituesit të grupit në lidhje me punën e audituesve të entitetit të kontrolluar, siç është aftësia e audituesit të grupit të rishikojë në mënyrë të duhur (ose të përfshihet në) punën e audituesve të entitetit të kontrolluar, d.m.th., nëse duhet të merren në konsideratë procedura alternative, dhe impakti mbi mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës së auditimit mbi të cilat bazohet opinioni i auditimit të grupit.

SNA-të Përkatëse

Çështje të Veçanta për të Marrë në Konsideratë



Çështje të tjera për të qenë vigjilent

- Nxjerrja në pah e aspekteve që kërkojnë vëmendje gjatë auditimit të çmuarjeve kontabël në një mjedis në zhvillim e sipër si pasojë e impaktit të COVID-19.
- Nxjerrja në pah e çështjeve për të marrë në konsideratë që lidhen me vijimësinë në mjesdisin aktual në zhvillim si pasojë e impaktit të COVID-19.
- Nxjerrja në pah e çështjeve për të marrë në konsideratë në lidhje me raportimin e audituesit në mjedisin aktual në zhvillim si pasojë e impaktit të COVID-19.
- Nxjerrja në pah e çështjeve për marrë në konsideratë për audituesit e sektorit publik në mjedisin aktual në zhvillim si pasojë e impaktit të COVID-19.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Referuar në këtë Publikim

SNA 315 (i rishikuar), Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Material e Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij

SNA 330, Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar

SNA 540 (i rishikuar), Auditimi i Çmuarjeve Kontabël dhe Informacionet Përkatëse Shpjeguese

SNA 560, Ngjarjet e Mëvonshme

SNA 570 (Rishikuar), Vijimësia

SNA 600, Konsiderata të Veçanta – Auditimi i PF të Grupit (duke përfshirë Punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)

SNA 700 (i rishikuar), Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare

SNA 701, Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur

SNA 720 (i rishikuar), Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Informacionet e Tjera në Dokumentet që Përbajnë PF e Audituar



“Nxjerrja në Pah e Aspekteve që Kërkojnë Vëmendje në një Mjedis Auditimi në Zhvillim si Pasojë e Impaktit të COVID-19” nga “IAASB”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Mars 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Maj 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Nxjerrja në Pah e Aspekteve që Kërkojnë Vëmendje në një Mjedis Auditimi në Zhvillim si Pasojë e Impaktit të COVID-19” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Nxjerrja në Pah e Aspekteve që Kërkojnë Vëmendje në një Mjedis Auditimi në Zhvillim si Pasojë e Impaktit të COVID-19” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli original: “Highlighting Areas of Focus in an Evolving Audit Environment Due to the Impact of COVID-19”

Kontakti Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.

